

PARTNERITETI PËR QEVERISJE TË HAPUR (OGP)

SHËNIMET E MBLEDHJES SE KOMITETIT

9 SHKURT 2023

MBLEDHJA E KOMITETIT SHUMËPALËSH MBI PARTNERITETIN PËR QEVERISJE TË HAPUR

Vendi: Kryeministria, Kati tretë

Data: 09.02.2023

Kryesohet: Znj. Milva EKONOMI, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve, Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP)

Aneks 1: Lista e pjesëmarrjes së anëtarëve dhe të ftuarëve në Komitet paraqitet në Aneksi I

Aneks 2: Konkluzionet Operacionale paraqitet në Aneksi II

Aneks 3: Dokumenti i Prioriteteve paraqitet në Aneksi III

Aneks 4: Raporti i Bashkë-bërjes për identifikimin e prioriteteve paraqitet në Aneksi IV

Aneks 5: Evidencat e procesit të bashkë-bërjes paraqitet në Aneksi V

I. Hapja e mbledhjes dhe çështjet e diskutuara sipas agjendës/çështjeve për parashtrim:

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve, hapi mbledhjen duke falënderuar anëtarët e Komitetit për prezencën e tyre në këtë mbledhje të tretë, që diskuton dhe aprovon dokumentin e prioriteteve në kuadër të procesit të bashkë-bërjes në zbatim të Planit Kombëtar OGP 2022-2024 e cila vijohet në përputhje me Planin e Punës për hartimin e planit.

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve, parashtrori se është dërguar paraprakisht paketa e dokumentit të prioriteteve, raporti i bashkë-bërjes dhe evidenat e gjithë procesit të ndjekur për identifikimin e prioriteteve së bashku me shoqërinë civile.

Koordinatorja Kombëtare theksoi se tashmë kanë kontribuar 12 institucione me rreth 32 angazhime prioritare në 8 fusha/komponentë në kuadër të procesit të bashkë-bërjes. Më

specifikisht janë hartuar 8 anketa online ku janë publikuar në faqen www.ogp.al, janë zhvilluar rreth 11 takime konsultative tematike me shoqërinë civile, e cila tregon një proces gjithëpërfshirës dhe në përputhje me Standardet e OGP-së.

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve **falenderoi anëtarët e Komitetit dhe Rrjetin OGP të cilat kanë bashkëvepruar në mënyrë efikase dhe rekomandoi që të gjithë institucionet që akoma nuk kanë caktuar pikën fokale do të duhet të bëjnë sa më shpejt.**

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve nënvizoi se **Komiteti përbëhet nga tre (3) nivele, respektivisht: (i) niveli i parë ka lidhje të drejtpërdrejtë me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC); (ii) niveli i dytë lidhet në mënyrë aktive dhe me Komitetin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) dhe (iii) niveli i tretë lidhet me anëtarësinë dhe ndërveprimin brenda Komitetit Shumëpalësh për Qeverisjen e Hapur.**

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve theksoi domosdoshmërinë e një bashkëbisedimi të hapur por dhe forcimi të kapaciteteve me të gjithë anëtarët si nga ana e qeverisë ashtu dhe nga shoqëria civile. **Në këtë kontekst, anëtarët u informua lidhur me planifikimin e një trajnimeve si për (i) anëtarët e Komitetit dhe (ii) rrjetit të OGP-së brenda muajit shkurt e cila po bashkërendohet me OGP-në dhe ReSPA-n.**

II. Cështjet e diskutuara sipas rendit të ditës

Cështja 2: Përmbledhje e sintetizuar e diskutimeve të anëtarëve të Komitetit Shumëpalësh për Qeverisjen e Hapur lidhur me Dokumentin e Prioriteteve në kuadër të procesit të bashkëbërjes

Ministria e Drejtësisë (2 angazhime)

Ministria e Drejtësisë prezantoi dy angazhime prioritare në fushën e rritjes së ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për mekanizma dhe instrumenta që përdoren nga publiku i gjerë në fushën e antikorrupsionit (I) dhe të aksesit në drejtësi (II).

Angazhimet janë të ndërlidhur fort me:

- Zbatimin e Reformës në Drejtësi;
- Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND);
- Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur (SDM);
- Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP);
- Strategjinë Ndërsektoriale Anti-Korrupsion (SNKK);
- Gjetjet e **Raportit të Komisionit Evropian** për Shqipërinë;

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe grupeve të interesit për çështje të aksesit në drejtësi (I) dhe se si qytetarët mund të përdorin mekanizma për të përfituar këtë të drejtë dhe të antikorrupsionit dhe të mekanizmave që mund të përdoren për denoncimin e rasteve korruptive (II) janë tashmë prioritete të MD dhe që duhen promovuar më tej. Promovimi dhe edukimi i publikut janë me rëndësi sepse lehtësojnë veprimtarinë e institucioneve publike dhe bashkëpunimin e tyre me qytetarët në ushtrimin e fushës së përgjegjësive dhe

angazhieme të transparente dhe të mira efektivisht. Transparenca në përdorimin e këtyre mekanizmave është e shtuar gradualisht dhe e mbështetur në dokumenta të tjera strategjike që drejtohen nga MD, por përfshirja në mënyrë eksplicite në PKV të OGP për vitet 2022-2024 i jep një vlerë të shtuar angazhimit konkret.

Për këtë proces u krye një Anketim/sonadazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes si dhe u zhvilluan dy takime me shoqërinë civile (evidencat e procesit bashkëlidhur në aneksi).

Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacioni/AKSHI (4 angazhime prioritare)

AKSHI prezantoi katër angazhime prioritare specifikuish:

1. Shtimi i të dhënave automatike në portalin e të dhënave të hapura dhe aksesit në Gatishmërinë e të dhënave të hapura (Open Data Readiness).
2. Identifikimi i ngjarjeve proaktive të jetës dhe zbatimi i të paktën 1 ngjarje jetësore (Life Event) në e-Albania në portalin e qeverisë E-Albania.
3. Transpozimi i direktivës së BE-së për aksesueshmërinë në ueb/përportalet qeveritare (Direktiva e aksesueshmërisë në ueb (BE) 2016/2102 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik”).
4. Zhvillimi i mekanizmit të vlerësimit nga ana e qytetarëve për shërbimet elektronike.

Për këtë proces u krye një Anketim/sonadazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes si dhe u zhvillua një takim me shoqërinë civile (evidencat e procesit bashkëlidhur në aneksi).

Ministri i Shtetit për Sipërmarrje (1 angazhim prioritar)

MSHMS prezantoi një angazhim prioritar specifikuish:

1. Promovomimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen.

Për këtë proces u krye një Anketim/sonadazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes si dhe u zhvillua një takim me shoqërinë civile (evidencat e procesit bashkëlidhur në aneksi).

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve prezantoi tre prioritetet e sektorit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, specifikuish:

Ministria e Shëndetësisë (3 angazhime prioritare)

1. Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut e në mënyrë të veçantë grupet në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse.
2. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGRBTI, të moshuarit.

3. Forcimi i bashkëpunimit dhe mekanizmave monitorues me aktorët e shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të veçanta;

Për këtë proces u krye një Anketim/sonadazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes si dhe u zhvillua një takim me shoqërinë civile (evidencat e procesit bashkëlidhur në aneksi).

Ministria e Arsimit (2 angazhime prioritare)

MASR prezantoi katër angazhime prioritare specifikuist:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë për rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim.
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi ndikimin e digjitalizimit të sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqërie bazuar në dije.

Për këtë proces u krye një Anketim/sonadazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes si dhe u zhvilluan dy takime me shoqërinë civile (evidencat e procesit bashkëlidhur në aneksi).

Ministria e Financave dhe Ekonomise (3 angazhime prioritare)

MFE prezantoi katër angazhime prioritare specifikuist:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e tëardhurave
3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike

Për këtë proces u krye një Anketim/sonadazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes si dhe u zhvilluan dy takime me shoqërinë civile (evidencat e procesit bashkëlidhur në aneksi).

Ministri Shtetit për Rinine dhe Femijet (2 angazhime prioritare)

MSRF prezantoi dy angazhime prioritare specifikuist:

1. Rishikimi i Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”
2. Ngritja e Bazës së të Dhënave për organizatat rinore

Për këtë proces u krye një Anketim/sonadazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes si dhe u zhvillua një takim me shoqërinë civile (evidencat e procesit bashkëlidhur në aneksi).

Ministria e Mbrojtjes (3 angazhime prioritare)

MM prezantoi tre angazhime prioritare specifikuist:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi kontributin e Mbrojtjes në drejtim të sigurimit dhe ruajtjes së cilësisë së jetës së qytetarit, si dhe në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët, në ndërtimin e një mjedisi sigurie më të qëndrueshëm.
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transformimin e instrumentit ushtarak dhe krijimi i një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm bazuar në inovacionin teknologjik.
3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi rëndësinë e dialogut në hartimin e politikave dhe bashkëpunimit të ngushtë civilo-ushtarak.

Për këtë proces u krye një Anketim/sonadazh Online në kuadër të procesit të bashkë-bërjes si dhe u zhvillua një takim me shoqërinë civile (evidencat e procesit bashkëlidhur në aneksi).

Ministria e Mbrojtjes në kuadër të angazhimeve propozoi potencialisht që prioritetet e propozuara mund dhe të sintetizohen.

Qendra Kombëtare e Biznesit/QKB (3 angazhime prioritare)

QKB prezantoi tre angazhime prioritare specifikesht:

1. Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi konceptin e pronarit përfitues dhe detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues;
2. Vlerësimi i praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues dhe integrimi i tyre në praktikat e vendit tonë;
3. Rishikimi i legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi identifikimin e pronarëve përfitues dhe dokumentet shoqëruese për regjistrimin e të dhënave të tyre.

Regjistrimi i të dhënave të pronarëve përfitues dhe përditësimi i tyre nga subjektet raportuese, sipas afateve dhe kërkesave të parashikuara në ligjin “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 1088, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave [“Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara”](#), i ndryshuar, mbetet angazhim i shtetit shqiptar.

Ndryshimet në ligjin e sipërcituar zgjeruan afatin përfundimtar të regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, duke përfshirë regjistrimin fillestar të tyre dhe ndryshimet e padeklaruara deri në datë 30 Qershor 2022. Nga verifikimi i kryer rezultoi se, në Regjistrin e Pronarëve Përfitues kanë deklaruar të dhënat e pronarëve përfitues 38,694 subjekte raportuese të regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe 2376 Organizata Jofitimprurëse, duke e ngritur nivelin e popullimit të këtij Regjistri në 97.43%.

Ndërkohë që, popullimi i Regjistrit të Pronarëve Përfitues me regjistrimin fillestar të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese ka arritur nivele të kënaqshme,

angazhim ngelet përditësimi, brenda afateve dhe në përputhje me ligjin, nga subjektet raportuese i të dhënave të pronarëve përfitues.

Ligji nr. 112/2020 parashikon se, në rastin e regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, regjistrimi bëhet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së ndryshimit faktik. Në këtë kuadër, përditësimi i të dhënave të pronarëve përfitues ngelet angazhim i këtij Plani Veprimi.

Me qëllim përmbushjen e këtij angazhimi vlerësohet marrja e masave të mëposhtme:

- sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi konceptin e pronarit përfitues dhe detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues;
- vlerësimi i praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues dhe integrimi i tyre në praktikat e vendit tonë;
- rishikimi i legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi identifikimin e pronarëve përfitues dhe dokumentet shoqëruese për regjistrimin e të dhënave të tyre.

Qendra Kombëtare e Biznesit ka zhvilluar takime me përfaqësues të subjekteve raportuese, me qëllim konsultimin e implementimit të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues, identifikimin e vështirësive dhe problematikave të hasura nga ata gjatë përmbushjes së detyrimit për regjistrim. Nisur nga zhvillimi i këtyre takimeve dhe nga praktikat e ndjekura nga institucioni që prej hyrjes në fuqi të ligjit vlerësohet i nevojshëm marrja e masave të sipërcituara, me qëllim përmbushjen e angazhimit.

Agjencia e Bashkëqeverisjes (7 angazhime prioritare)

Agjencia e Bashkëqeverisjes prezantoi shtatë angazhime prioritare specifiku:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i qytetarëve dhe biznesit me fokus denoncimin e akteve korruptive përmes seksionit online "Denonco korrupsionin" në Platformën e Bashkëqeverisjes.
2. Fushatë ndërgjegjëse gjithëpërfshirëse në çdo bashki mbi zbatimin e ligjit 107/2021 "Për bashkëqeverisjen", promovimi i seksioneve të Platformës dhe parandalimi i kulturës së pandërshkueshmërisë në administratë.
3. Promovimi i ndërveprimit me qytetarët dhe biznesit përmes adresimit dhe rasteve të zgjidhura të ankesave dhe kërkesave të tyre në Platformën e Bashkëqeverisjes.
4. Fuqizimi i mekanizmit të bashkëqeverisjes me qytetarët dhe biznesin përmes realizimit të seksioneve të Platformës së Bashkëqeverisjes.
5. Realizimi i kontroleve periodike mbi problematikën të ripërsëritura në lëvrimin e shërbimeve dhe anashkalimin e procedurave administrative.
6. Rritja e transparencës dhe cilësisë së shërbimit përmes monitorimit të performancës së punonjësve dhe institucioneve në kuadër të Sistemit të Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik.
7. Rritja e përgjegjshmërisë dhe efikasitetit të institucioneve përmes zbatimit të masave korrektuese administrative dhe financiare.

Departamenti Rregulator dhe i Përputhshmërisë, Kryeministria (1 angazhim prioritar)

Departamenti prezantoi një angazhim prioritar specifikisht:

1. Vlerësimi i ndikimit, programimi i akteve rregulatore dhe konsultimi publik të jenë në themel të një sistemi politikbërjeje të bazuar në të dhëna, të mirë planifikuar dhe që mundëson aksesin e publikut në vendimarrje, për një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse.

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin (1 angazhim prioritar): Institucioni udheheqës

MSHMP prezantoi një angazhim prioritar specifikisht:

1. Bashkërendimi i Ministrisë të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin për të përmirësuar efektivitetin e punës dhe për ta bërë Parlamentin më të hapur dhe transparent.

Gjithashtu MSHMP prezantoi dhe një ide për një angazhim të ri që lidhet dhe në kuadër të një projekti që po implementohet e cila lidhet me ngritjen e një sistemi e-legislation, e cila mund të inkorporohet dhe do të ishte e vlefshme dhe në kuadër të Planit të OGP-së.

Ministria e Brendshme në kuadër të angazhimeve propozoi potencialisht kontributin në kuadër të prioritetëve në dy angazhime që lidhen me (i) mbështetjen lidhur me fëmijër vunerabël dhe (ii) policimi në komunitet.

Agjencia e Prokurimit Publik në kuadër të angazhimeve hodhi idenë e vendosjes së prioritetit që lidhet me forcimin e e regjistrisë të prokurimeve që parashikon tre komponentë (i) sistemin e menaxhimit për shqyrtim të ankesave (ii) sistemin e menaxhimit të kontratave dhe (iii) sistemin e menaxhimit lidhur me kontratat koncencionare.

Anëtarët e Komitetit të Shoqërisë Civile

Anëtari i Shoqërisë Civile z. Endrit u shpreh se si anëtar i OSHC në Komitetin e OGP-së ndihet i kënaqur për gjithë këtë proces gjithëpërfshirës dhe vlerëson të gjithë prioritetet që janë bashkë-bërë me shoqërinë civile. Ai vlerëson të gjithë prioritetet por vecanërisht rol të rëndësishëm do të ketë dhe prioriteti që lidhet me konsultimin publik.

Anëtari i Shoqërisë Civile z. Altin u shpreh se si anëtar i OSHC në Komitetin e OGP-së përgëzon gjithë këtë proces transparent ku janë përfshirë organizatat e shoqërisë civile ku dhe janë kryer shumë konsultime për identifikimin e prioritetëve.

Anëtari i Shoqërisë Civile znj. Ermelinda u shpreh se si anëtar i OSHC në Komitetin e OGP-së se përgëzonte procesin e kryer, por parashitroi disa çështje lidhur me procesin e konsultimit si çështje prioritare, specifikisht:

- Pjesa e aksesit në konsultim: paraqitet e nevojshme gjetja e mekanizmave dhe kanaleve të komunikimit;
- Targetimi i komenteve në kuadër të procesit të konsultimit publik;

- Qëndrueshmëria e planit analitik legjislativ dhe gjetja e instrumentave për njoftime të hershme për procesin e konsultimit publik;

Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile si agjenci për mbështetjen e OSHC-ve garantoj që lidhur me marrjen e masave për njoftime të vazhdueshme për OGP-në ai do të garantojë si një instrument i ndërmjetëm të njoftojë sa më shumë organizata dhe do të përdorë databzën e agjencisë për (i) promovim të OGP-së dhe (ii) njoftime të sa më shumë organizatave për një gjithpërfshirje sa më të madhe të organizatave në këtë proces.

Cështja 3: Aprovimi i Dokumentit të Prioriteteve në kuadër të procesit të bashkëbërjes

Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve pasi dëgjoi të gjithë anëtarët sipas procedurave kërkoi aprovimin e dokumentit të prioriteteve e cila u zhvillua me bashkëbërje të shoqërisë civile.

Anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin sipas diskutimeve dhe u la kohë deri më 11.02.2023 të rakordohet dokumenti sipas diskutimeve dhe konkluzioneve.

Dokumenti i prioriteteve si paketë me dokumentet e mëposhtëm publikohen në faqen e www.ogp.al nga AKSHI.

Paketa e aprovimit:

Shënimet e mbledhjes së Komitetit OGP datë 09.02.2023

Agjenda e mbledhjes së Komitetit OGP datë 09.02.2023

Aneks 1: Lista e pjesëmarrjes së anëtarëve dhe të ftuarëve në Komitet paraqitet në Aneksi I

Aneks 2: Konkluzionet Operacionale paraqitet në Aneksi II

Aneks 3: Dokumenti i Prioriteteve paraqitet në Aneksi III

Aneks 4: Raporti i Bashkë-bërjes për identifikimin e prioriteteve paraqitet në Aneksi IV

Aneks 5: Evidencat e procesit të bashkë-bërjes paraqitet në Aneksi V

Konkluzione:

1. **Në përputhje me kërkesën e kryer nga** Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve **të gjithë ministrat/institucionet të cilat nuk kanë caktuar një pikë kontakti duhet të paraqesin dhe caktojnë pikën e kontaktit lidhur me masat e zbatuara për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) si dhe planin e veprimit për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP).**
2. Dërgimi i prioriteteve nga Ministria e Brendshme të cilat do të dërgohen në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkuorpuar në dokumentin e prioriteteve.
3. Sintetizim i prioriteteve nga Ministria e Mbrojtjes të cilat do të dërgohen në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkuorpuar në dokumentin e prioriteteve.
4. Dërgimi i prioriteteve nga Agjencia e Prokurimeve Publike që lidhet me forcimin e e regjistrisë të prokurimeve që parashikon tre komponentë (i) sistemin e menaxhimit për

shqyrtim të ankesave (ii) sistemin e menaxhimit të kontratave dhe (iii) sistemin e menaxhimit lidhur me kontratat koncensionare, që do të dërgohen në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkorporuar në dokumentin e prioriteteve.

5. Dërgimi i prioriteteve nga Ministria e Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin e cila do të dërgohen në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkorporuar në dokumentin e prioriteteve.
 6. Dërgimi i sugjerimeve shtesë nga anëtarët e shoqërisë civile të Komitetit të cilat do të dërgohen në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Standardet e Shërbimeve për tu inkorporuar në dokumentin e prioriteteve.
 7. Anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin sipas diskutimeve dhe në përputhje me procedurat paketa publikohet në faqen www.ogp.al
-